

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale                                                                                        |
| ADRESA  | <a href="https://dosja.al/live-updates/fare-po-ndodh-ne-rinas-rama-le-gazetaret-jashte-dhe-anulon-konferen-i516313">https://dosja.al/live-updates/fare-po-ndodh-ne-rinas-rama-le-gazetaret-jashte-dhe-anulon-konferen-i516313</a> |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 27 shtator 2026, 12:28:42 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 12:11:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                    |
|------------|--------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | bfb3a60211d23f5455d82bdcbb41bd9cd036e78224cf5dd68ca6b8c85a6ef77d54 |
| TEKSTI     | b622c22e714964b7dbb0660684263ed46f9f05fdc43afd7f5533a9634507c216   |
| PAMJA      | 6415048943836ac70055a52c6b4cfc8e55affddd3a311e56d866ff802afc63de   |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | cae0145c6c38c197c2bf6d4d9b606cac9e50e0c7e87220ae0dc7e2f698343e19                                |
| E MËPARSHMJA  | 5c6ecdc88719c382bcfb5268eef3d822d5b8a217cf5c504d2ca1c8b7e505b8c2                                |
| RRËNJA MERKLE | 9def72ec67cc19e19d7afdb89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cae0145c6c38c197c2bf6d4d9b606cac9e50e0c7e87220ae0dc7e2f698343e19>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





## LIVE UPDATES ▾

20 SEKONDA ME PARE

Kryeministri anuloi konferencën me gazetarët, Berisha: Kapitullim pa kushte i Ramës. Bardhi: Përgjegjësia nuk shmanget

1 ORE ME PARE

Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale

18 ORE ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

21 ORE ME PARE

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

## LIVE UPDATES

## Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale

• Kryeministri Edi Rama ka komentuar masën e 'arrestit shtëpiak' ndaj ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni dhe sulmuar mediat në lidhje me trajtimin e kësaj çështje. • Rama i ka dalë në mbrojtje Hysenit duke e quajtur masën ndaj saj si "ekstreme", por shtoi se nuk do të ndërhyjë në përmbajtjen e dosjes. • Kryeministri e cilësoi çështjen e ish-drejtoreshës së SHISH si një çështje individuale mes saj dhe drejtësisë, duke theksuar se institucionet duhet të kryejnë detyrat e tyre përkatëse. • Rama foli edhe për reformën në drejtësi, duke deklaruar se koha e pandëshkueshmërisë ka marrë fund pasi sistemi po shfaq aftësi vetëpastrimi. • Në fjalimin e tij nga Rinas, Kryeministri u shpreh se pavarësia e drejtësisë nuk erdhi vetëm nga SHBA dhe Europa, por edhe nga vendimmarrja e tij. • Në deklaratat e tij, Rama akuzoi kundërshtarët politikë se e shohin SPAK-un si një armë kundër tij. • Ndërsa për mediat, Rama përdori termin "lavatriçe mediatike" dhe pretendoi se ato përdoren për të ndërtuar akuza ndaj qeverisë dhe për të ndikuar mbi drejtësinë. • Kërkesat e protestuesve që vazhdojnë për më shumë se 100 ditë në protestë për dorëheqjen e tij, Rama i hodhi poshtë duke mohuar kategorikisht që një gjë e tillë mund të ndodhë.

14 artikuj për këtë temë.

5 MINUTA ME PARE

### “Mund të thonë se oligarkët fitojnë lekët me mua”, Rama: S’ka një provë të vetme që një bir nëne të ketë një qindarkë të tijen në xhepin tim



**TIRANË-** Kryeministri i vendit, Edi Rama, mohoi akuzat kundrejt tij për fuqizimin e korrupsionit në institucionet shtetërore me “bekimin” dhe pjesëmarrjen e tij. Rama tha se nuk ka kryer kurrë veprën penale të korrupsionit gjatë mandateve në krye të Bashkisë Tiranë, apo prej më shumë se 13 vitesh si kryeministër i vendit.

Kryeministri tha se çdo investitor që ka përfituar mundësi investimi apo zhvillimi të pronës nga firma e tij, e ka përfituar plotësisht konform ligjit.

## editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

## Në vëmendje

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:45

Xing në Rinas/ Rama vjen nga SHBA, Berisha largohet për në Strasburg (VIDEO)

"Tani unë me siguri dhe e them sinqerisht duhet të kem fajet e mia, padiskutim. Por ajo që mund të them me sigurinë më të madhe është se kurrë, në asnjë rast e për asnjë arsye, mua nuk më bën dot askush palë, për asgjë që në të 28 vjet e 4 muajt e shërbimit tim publik, mund të ketë prekur paratë e shqiptarëve, pronat e shqiptarëve, interesat e shqiptarëve. Patjetër që mund të dalin plot e të flasin në emrin tim, apo kundër emrit tim. Mund të thonë se pas një kërkesë personale apo pune të tyre private, jam unë. Mund të thonë se pas një beme korruptive a një gjëme kriminale, jam unë. Mund të tregojnë përralla me arkitektët e tërë botës, mbledhur rreth meje për të pastruar paratë e kullave të mia.

Mund të rrefejnë historinë, me tërë kriminelët e Shqipërisë që mblidhen që të ftojnë zgjedhjet për mua. Mund të thonë se oligarkët e Shqipërisë i ftojnë lekët me mua, që u shes atyre nën dorë copa Shqipërie dhe jetoj në saraje luksoze, e fluturoj në tërë qiejt e botës me avionë privatë, të paguar dhjetra miliona euro me taksat e shqiptarëve. Të tëra e shumë më shumë se këto i kanë thënë dhe mund t'i thonë përsëri e përsëri, bashkë me të tjera të reja, që do t'u pjëllë mendja e fantaksur prej luftës për pushtet apo e urrejtjes për vajmedet. Po ama një provë të vetme, që një bir nëne ta ketë një qindarkë të tijën në xhepin tim apo në të ardhurat e familjes sonë, dhënë në këmbim të një firme të vetme të hedhur nga unë si kryebashkiak apo si kryeministër, nuk e nxjerrin dot kurrë. Sepse nuk ka lindur akoma ai lloj fenomeni.

E përsëris, unë mund të kem fajet e mia me siguri, nuk jam ëngjëll e as i pagabueshëm nuk jam jo e jo. Por faji që me siguri absolute nuk kam bërë kurrë, është që të tregtoj për para a për prona, pushtetin që shqiptarëve ua kam kërkuar për të rilindur Tiranën e pastaj edhe Shqipërinë. Kush më njeh e di mirë çfarë flas. Kush ka përfutur të drejta kushtetuese zhvillimi të pronës a mundësi të ligjshme investimi, edhe falë firmës sime, e di po aq mirë se çfarë flas. E di mirë çfarë flas po ashtu, kur ju them se pushteti im s'është përdorur kurrë për të dhënë favore të errëta apo për të marrë dhurata të paligjshme," tha Rama./Dosja.al

40 MINUTA ME PARE

## Qytetarët kërkojnë dorëheqjen, Rama: Asgjë nuk do të më ndalë



Edi Rama

**TIRANË-** Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas kërkesave për dorëheqjen e tij, duke deklaruar se asgjë nuk do ta ndalë atë dhe se Shqipëria nuk do të kthehet pas. Në mesazhin e tij nga Rinas, Rama foli për zhvillimet në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit, duke e cilësuar procesin e vetëpastrimit të sistemit si një ndryshim të rëndësishëm.

Ai u shpreh se ndryshimet që po ndodhin janë pjesë e një procesi që nuk mund të kthehet pas.

"Ky adresim lidhet me çka po ndodh me korrupsionin e me drejtësinë, e cila është një prej rezultateve historike të misionit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian. Korrupsioni vazhdon të jetë një hije e rrezikshme përgjatë rrugës sonë, por ndryshimi historik është se ai sot përballet me një tjetër sistem, ku janë formësuar e po zhvillohen organe që hetojnë, akuzojnë, gjykojnë dhe konfiskojnë në liri e pavaresi të plotë. Deri dje korrupsioni ishte sistemi, sot sistemi po e lufton korrupsionin dhe ky është një ndryshim epokal që ka nisur. Vetëpastrimi i sistemit në këtë fazë ende në formësim të shtetit të ri europian të Shqipërisë është i zhurmshëm. Madje është nganjëherë edhe i pistë dhe shpeshherë po shumë i dhimbshëm.

Ai prek e lëndon edhe individë të pafajshëm, ashtu sikundër keqtrajton e dehumanizon këdo edhe të fajshmit. Por vetëpastrimi i sistemit është një zhvillim i shumëpritur në organizmin e shtetit, pas një agonie tejet të gjatë sa historia e shtetit shqiptar. Organizmi i shtetit po fiton imunitet nga sëmundjet e vjetra, e kur kjo fazë e zhurmshme, e pistë dhe e dhimbshme të ketë kaluar; kur emrat, sekretet, jargët, shkroftimet e piskamat e tezgave mediatike të jenë fashitur; kur tymrat e pasqyrave digjitale të jenë shpërndarë e pluhurat e kantierit të Reformës në Drejtësi të jenë tretur, atëherë të gjithë do ta shohin se këto zhvillime, janë pjesë jetike e ndryshimit rrënjësor pa kthim ku po ecën sot Shqipëria. Sot unë jam kthyer në Shqipëri, po Shqipëria nuk kthehet pas. Askush dhe asgjë nuk do ta ndalë, nuk do të na ndalë, nuk do të më ndalë", tha Rama./Dosja.al

45 MINUTA ME PARE

## Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:38

**Çfarë po ndodh në Rinas?  
Rama lë gazetarët jashtë  
dhe anulon konferencën,  
video-mesazhi shpërndahet  
me regji nga Kryeministria**

AKTUALITET 27 SHTATOR 2026, 10:41

**VIDEO/ Me destinacion  
Greqinë, kapen 91 kg drogë në  
Kakavijë**

### më të klikuarat

Çfarë po ndodh në Rinas?  
Rama lë gazetarët jashtë  
dhe anulon konferencën,  
video-mesazhi shpërndahet  
me regji nga Kryeministria

Shpresë për familjen  
Kotorri/ Emisioni italian  
publikon foton e ngjashme  
me Rajmonda Kotorrin që u  
zhdruk 16 vjeçe në Itali

Shisnin drogë pranë  
shkollave në Tiranë, goditen  
disa grupe! 31 të arrestuar,  
14 të tjerë në kërkim  
(VIDEO)

Eriselda Sefa e korrigjon  
këngën për Enver Hoxhën  
me Cilleon, reperi koncert  
falas në Lushnjë

### insights

**Bledian Koka**  
**Pse Rama i denoncoi  
shqiptarët si  
antisemitë në OKB**

**Besmir Semanaj**  
**Kur të bie Diella në  
kokë**

**Rezarta Gagani**  
**Përballë pallatit tim  
po ndërtohet një  
pallat**

**Auron Janku**  
**Kur PARTITË  
harrojnë pse  
ekzistojnë**

**Moti**

Powered by tomorrow.



Edi Rama

**TIRANË-** Kryeministri Edi Rama ka sulmuar 2 media gjatë fjalimit të tij në Rinas. Rama i ka akuzuar këto televizione për përdorim të fondeve të paligjshme dhe për ndikim mbi organet e drejtësisë, duke i quajtur si 'lavatriçe mediatike'.

*"E di që edhe sot e gjithë ditën ata katër të vrarë në bulevard nuk kanë marrë ende drejtësi. E di gjithashtu, e di që çka me të , që me paratë e fabrikës së vdekjes në Gërdec u financua nga fajtorët e pahetuar ende gjermësot, ngritja e një lavatriçeje mediatike që kurdis sot e gjithë ditën ato "bombat çudibërëse" anti-qeveri, "Korrupsion - Korrupsion - Korrupsion, na mbyti korrupsioni". E di edhe që një tjetër televizion "Korrupsion - Korrupsion - Korrupsion, na mbyti korrupsioni", i ushqyer nga paratë e evazionit marramendës fiskal, ka marrë peng një prokuror të tërë në Tiranë, ku në vend se të thirret evazori i madh për të dhënë llogari për milionat e detyrimeve ndaj shtetit, prokurorët e trembur dhe të tredhur prej tij, hapin çështje për të trembur punonjësit e tatimeve që denoncojnë evazorin," tha Rama./Dosja.al*

51 MINUTA ME PARE

## Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua, SHBA-ja dhe BE-ja do kishin bërë Noc Rrokun



Edi Rama

**TIRANË-** Kryeministri Edi Rama ka folur për reformën në drejtësi, duke theksuar se ajo ka ardhur nga roli që ka pasur Partia Socialiste në realizimin e saj. Nga Rinas, Rama deklaroi se pavarësia e drejtësisë nuk erdhi vetëm nga mbështetja e SHBA-së dhe Europës, por nga vendimmarrja e politikës shqiptare.

Ai tha se mbështetja ndërkombëtare ka qenë e rëndësishme, por pa angazhimin e qeverisë shqiptare reforma nuk do të ishte realizuar në të njëjtën mënyrë.

"Ndërsa sot, për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, vetë sistemi institucional i Shqipërisë po shfaq aftësi vetëpastrimi që s'i ka pasur kurrë, kjo është një arritje e madhe kombëtare, autorësinë e të cilës, ndjesë, po nuk e negocioj me askënd; është imja dhe e Partisë Socialiste të Shqipërisë. Pavarësia e drejtësisë nuk ra nga qielli. Nuk e solli koha. As Amerika apo Europa. Ata ndihmuan po, madje shumë, por pa mua dhe Partinë Socialiste ata do kishin bërë të njëjtin Noc Rrok që bënë me qeveritë e mëparshme, deri diçka kur ne i hymë atij deti në këmbë - apo që po bëjnë me disa qeveri të tjera rrotull në rajon. Dhe padyshim, nuk e solli pavarësinë e drejtësisë PeDeja, sorrat, korbat e dështakzemërakët, që sot bërtasin "Korrupsion - Korrupsion - Korrupsion, na mbyti korrupsioni" dhe e shikojnë SPAK-un si armën e vetme fatale kundër meje, që i kam mundur e mundur në çdo zgjedhje, e që i mund në këto betejat e shpifura të arenës politike dhe mediatike të akuzave e të shpifjeve, sa herë u gënjen mendja se më zunë ngushtë e ma bënë gropën", tha Rama./Dosja.al

1 ORE ME PARE


## Rama sulmon deputetët: Pisanjosë me kostum parlamentar, dhuratat e mia janë pronë e shtetit



Edi Rama

**TIRANË-** Kryeministri Edi Rama ka reaguar ndaj akuzave të opozitës se ka marrë si dhuratë një orë të shtrenjtë nga krimi i organizuar. Duke folur nga Rinasi, Rama i ka quajtur deputetët e opozitës si pisanjosë me kostum parlamentar.

Rama tha se të gjitha dhuratat që ka marrë gjatë detyrës si kryeministër janë regjistruar si pronë e shtetit shqiptar dhe se ato nuk i ka marrë për t'i çuar në shtëpinë e tij.



*"Sot në kryeministrinë e Republikës së Shqipërisë, ka një muze të dhuratave që merr kryeministri. Atyre pisanjosëve me kostum parlamentar apo me sqep sorrash e korbash në vend të buzëve, të cilët ndër plot jashtëderdhjet e tyre në mexhelisin e Shqipërisë, kanë nxjerrë edhe një orë super të shtrenjtë, që unë e paskesha marrë dhuratë nga krimi i organizuar, u them se në atë muze ka thujse një duzinë orash të shtrenjta e super të shtrenjta, të cilat më janë dhuruar mua, personalisht, jo nga kriminelë po nga miq të fuqishëm a vizitorë shumë të nderuar.*

*Por ndryshe nga paraardhësi im, që i ka përllarë të tëra bashkë, me tërë dhuratat e tjera të tetë viteve të tij në zyrën e kryeministrit, unë i kam regjistruar të gjitha dhuratat për kryeministrin si prona të shtetit shqiptar. Sepse çfarë vjen për mua si kryeministër dhe çfarë më takon të kem si kryeministër, nuk vjen as për ta çuar në shtëpinë time, as për ta pasur edhe për veten time. Prandaj për shembull privatisht unë udhëtoj gjithnjë njësoj si çdo shqiptar tjetër ose prandaj fjala vjen, makina ime merret me qera nga partia, nuk blihet nga kryeministria, përderisa përdoret edhe për udhëtime partie e jo vetëm qeverie,"* tha Rama./Dosja.al

1 ORE ME PARE

## Rama bën ironi me Opozitën: Qeveria gjykohet nëse lë drejtësinë të bëjë punën





Edi Rama

**TIRANË-** Kryeministri Edi Rama iu përgjigj me ironi akuzave të opozitës pas arrestimit të ish-kreut të SHISH, Vlora Hyseni, duke thënë se sipas kësaj logjike përgjegjës për çdo rast do të ishte vetë ai. Rama tha se një kryeministër nuk mund të konsiderohet përgjegjës për shkeljet e ligjit nga persona që kanë punuar me të apo pranë tij, ndërsa theksoi se qeveria duhet të gjykohej nga qëndrimi që mban kur një zyrtar përballet me drejtësinë.

Sipas tij, qëndrimi i qeverisë duhet të vlerësohet nëse justifikon, mbron apo i kundërvihet drejtësisë kur një person pranë saj përballet me një hetim.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.